

I. LISTA ME PËRMBAJTJEN E RAPORTIT TË MONITORIMIT

- II. Hyrje
- III. Informacion buxhetor i agreguar për buxhetin e AIDSSH-së Janar – Prill 2026
- IV. Performanca e treguesve kyç të performancës me bazë gjinore në nivel produkti
- V. Performanca e buxhetit në nivel programi
 - a. *V.1 Performanca financiare e programit buxhetor*
 - b. *V.2 Performanca jo - financiare e programit buxhetor*
 - c. *V.3 Veprimet vijuese në nivelin e programit buxhetor*
- VI. Projektet kapitale
- VII. Nryshimet në buxhet
- VIII. Përfundime

Aneksat bashkëlidhur:

- Aneksi nr. 1 Raporti përmbledhës i shpenzimeve të institucionit buxhetor
- Aneksi nr. 1.1 Raporti i shpenzimeve të institucionit buxhetor sipas kapitujve
- Aneksi nr. 1.2 Shpenzimet buxhetore në total programi dhe institucioni buxhetor
- Aneksi nr. 2 Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit"
- Aneksi nr. 2.1 Shpenzimet e programit sipas kapitujve
- Aneksi nr. 3 Raporti i performancës së produkteve të programit
- Aneksi nr. 3.1 Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikujve
- Aneksi nr. 3.2 Deviacioni koston për njësi në vite
- Aneksi nr. 4. Raporti i realizimit të treguesve të performancës së programit

II. HYRJE

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit është institucion i pavarur që ushtron veprimtarinë e tij në zbatim të Ligjit nr. ligjit 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore” i ndryshuar dhe konsiston në këto drejtime:

- Përpunimi i kërkesave për informim nga Institucionet dhe individët dhe sigurimi i aksesit të qytetarëve në të dhëna nëpërmjet procedurave të qarta dhe transparente, me afate për periudhën 29 Nëntor 1944 – 2 Korrik 1991.
- Rritja e cilësisë së funksionimit të Autoritetit nëpërmjet procedurës së përpunimit të kërkesave për informim të individëve të prekur dhe autoriteteve kushtetuese dhe institucioneve publike.
- Sigurimi i aksesit në të dhëna për kërkuesit historianë dhe median si subjekte të parashikuara nga Ligji Nr.45/2015, nëpërmjet procedurave të qarta dhe transparente, me afate për periudhën 29 Nëntor 1944 – 2 Korrik 1991.
- Mbrojtja e të dhënave e në mënyrë të veçantë e atyre të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar dhe e të dhënave personale
- Ndjekja e zbatimit të strategjive ndërsektoriale në kuadër të të drejtës për informim, lidhur me indikatorët e matshëm.
- Identifikimi dhe Rikuperimi i personave të Zhdukur.

Qëllimi i Autoritetit është (i) të identifikojë, mbledhë dhe krijojë një arkiv të integruar të të gjitha dokumenteve të njohura të prodhuara nga/ose të lidhura me veprimtarinë e ish-Sigurimit, (ii) të bëjë regjistrimet në dispozicion të publikut sipas dispozitave të parashikuara në ligj, duke përfshirë sigurimin e qasjes në informata në formë dixhitale; (iii) krijimi i Autoritetit si një burim arkivor qendror, për hulumtimin e aktiviteteve të ish-Sigurimit, (iv) të drejtojë informimin publik për të krijuar Autoritetin si një platformë, për angazhimin dhe kuptimin e së kaluarës komuniste në Shqipëri, (v) mbështesë punën e dokumentimit të krimeve të komunizmit, duke përfshirë kontributin në bërjen e drejtësisë, (vi) mbështesë procesin e kërkimit, gjetjes, identifikimit dhe rimëkëmbjes së mbetjeve të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, (vii) mbështesë verifikimin e zyrtarëve që konkurrojnë për tu zgjedhur ose emëruar në administratën publike/shtetërore.

III. INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR PËR BUXHETIN E AIDSSH JANAR – PRILL 2026

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2026 administron dhe menaxhon fondet buxhetore për programin:

➤ **Planifikim, Menaxhim dhe Administrim (01110)**

Në Ligjin nr.87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, numri i përgjithshëm i punonjësve mbështetur në Vendimin e Kuvendit nr.113/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 95/2016 për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, të ndryshuar, është 73.

Për vitin 2026, mbështetur në ligjin e buxhetit, fondet e akorduara për Autoritetin në fillim të vitit janë në total në vlerën **196,450,000 lekë**.

Me shkresën nr.1269/1, datë 16.02.2026, të Ministrisë së Financave, “Mbi miratimin e detajimit të planit për fondin e vecantë për vitin 2026”, u miratua vlera prej 150.000 lekë në llogarinë 606

(transferta tek individet).

Me shkresën nr. 1868/1, datë 17.02.2026, të Ministrisë së Financave, “Mbi miratimin e riallokimit të buxhetit për vitin 2026”, Autoritetit ju alokua vlera prej 400.000 lekë në llogarinë 606 (transferta tek individet) duke pakësuar llogarinë 602 (mallra dhe shërbime).

Në total llogaria 606 është 550,000 lekë.

Në total plani i buxhetit me ndryshime për vitin 2026 është 196,600,000 lekë.

Programi	Buxheti fillestar 2026 (1)	Buxheti me ndryshime 2026 (2)	Diferenca (3=2-1)
Planifikim menaxhim administrim	196 450 000	196 600 000	150 000

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor i planit të buxhetit të rishikuar për vitin 2026, janë shpenzuar në total për periudhën 4-mujore **49,650,827 lekë**. Buxheti në total për periudhën 4-mujore Janar-Prill 2026 është realizuar në masën **25%**.

Fondi i pagave me plan buxheti 144,350 mijë lekë i ndarë respektivisht 122,050 mijë lekë (artikulli 600) për paga dhe 22,300 mijë lekë (artikulli 601) për sigurime është realizuar për numrin faktik të punonjësve respektivisht në vlerën 39,05 mijë lekë për paga si dhe 6,413 mijë lekë për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore. E shprehur në përqindje realizimi i fondit të pagave për periudhën 4- mujore është 31 % e fondit të planifikuar vjetor.

Në fund të 4-mujorit 2026 numri i punonjësve në organikë është 70 punonjës nga të cilët rezultojnë në fondin e pagave 69 punonjës (1 punonjës trajtohet nga fondi i sigurimeve shoqërore për leje lindje, 1 punonjës paguhet si invalid i pjesshëm me 6 orë pune).

Për periudhën Janar-Prill 2026 janë përfshirë në fondin e pagave 2 (dy) punonjës të rinj (niveli ekzekutiv) dhe është larguar 1 (një) punonjës (niveli i lartë drejtues). Numri total i punonjësve të shtuar në fondin e pagave është 4 (katër) punonjës.

Në Vendimin Nr. 10 datë 10.01.2026 numri i punonjësve me kontratë të përkohshme të miratuar për Autoritetin është 13 punonjës dhe numri faktik i punonjësve gjatë 4-mujorit 2026 është 11 punonjës.

Zëri mallra dhe shërbime me plan vjetor buxheti në vlerën 35,250 mijë lekë për periudhën Janar-Prill 2026 është realizuar në vlerën 4,188 mijë lekë. Në këtë zë përfshihen fondi për shpenzime operative (artikulli 602) në vlerën 34,700 mijë lekë dhe 550 mijë lekë (artikulli 606) janë transfera te individët (400 mijë lekë për rimbursimin e telefonisë celulare dhe 150 mijë lekë pagesa nga fondi i veçantë).

Shpenzimet operative për periudhën Janar-Prill 2026 janë realizuar në vlerën 12% e planit total vjetor.

Sa u takon shpenzimeve operative deri në fund të muajit Prill, theksojmë se ka procedura të përfunduara të cilat janë në proces për pagesë dhe procedura në proces prokurimi si më poshtë:

- Ka përfunduar procedura e blerjes së materialeve të pastrimit dhe është në proces për pagesë.
- Është lidhur kontrata e shërbimit të mirëmbajtjes të sistemit ngrohje-ftohje HVAC
- Ka përfunduar hartimi i dokumentave të shërbimit të mirëmbajtjes të MKZ dhe është në proces për publikim në APP.
- Në zërin “shpenzime për aktivitete” ka përfunduar 1 (një) procedurë prokurimi dhe janë në proces prokurimi dhe 3 (tre) procedura të tjera.

- Kanë përfunduar dy procedura për transport ajror
- Është në proces procedura për blerje materiale kancelarie
- Zëri “konceptim artistic i materialeve audiovizuale” është në proces të pritjes së dokumentacionit nga Operatori Ekonomik.
- Zërat “shërbim përkthimi” dhe “shërbim transporti” janë në proces prokurimi për 3 (tre) aktivitete që do të zhvillojë Autoriteti.

Fondi për shpenzime kapitale të trupëzuara (zëri 231) për vitin 2026 është në vlerën totale 17,000 mijë lekë sipas projekteve më poshtë:

1-Projekti 18BV402- llog 231, në vlerën 1,000,000 lekë “Blerje paisje informatike”

Për këtë projekt ka përfunduar një procedurë prokurimi por pagesa është kryer në muajin Maj. Gjithashtu po në muajin Maj ka përfunduar dhe një procedurë tjetër për të cilën po përgatitet dokumentacioni i nevojshëm për likuidim.

2- Projekti 18BV408- llog 231, në vlerën 200,000 lekë, me emërtimin “Blerje orendi, mobilje zyre”. Kjo procedurë e filluar në muajin Prill dhe ka përfunduar në Maj pasi disa prej Operatorëve Ekonomike janë tërhequr nga renditja.

4- Projekti 18BV410-llog 231, në vlerën 4,000,000 lekë “Blerje dhe instalim sisteme dhe paisje të rrjetit, serverave, licensa për backup dhe sigurinë kibernetike” . Për këtë projekt po hartohen specifikimet teknike dhe është në proces

5- Projekti 18BV412-llog 231, në vlerën 10,000,000 lekë “Blerje, instalim platforme digjitale e edukimit “Mësojmë nga e kaluara, burime arsimore të hapura 1944-1991”. Për këtë projekt është kryer testimi i tregut dhe praktika e plotë shoqëruar me termat e referencës është dërguar në OBP për zhvillimin e procedurës nëpërmjet kërkesës nr. 671 prot. datë 19.03.2026. Nga OBP për zhvillimin e mëtejshëm të procedurës, është dërguar fatura për kryerjen e pagesës të procedurës së prokurimit e cila është paguar në muajin Maj.

6- Projekti 18BV413-llog 231, në vlerën 1,000,000 lekë” Tendë mbrojtëse për kupolën ”.

Për këtë projekt është kryer testimi i tregut dhe janë duke u përgatitur dokumentat për hedhjen e procedurës së prokurimit në APP

7- Projekti 18BV414-llog 231, në vlerën 800,000 lekë “Ekspozitë e qëndrueshme”

Projektet për shpenzime kapitale sipas emërimit të tyre për periudhën Janar-Prill 2026, në planin financiar nuk janë realizuar.

Realizimi sipas zërave në mijë është si më poshtë:

NR.	Emërtimi	Plani Vjetor 2026	Fakti 4 Mujori viti 2026	Përqindja e realizimit
1	Shpenzime per paga	122 050	39 050	32%
2	Shpenzime per sig shoqërore	22 300	6 413	29%
3	Shpenzime të tjera korrente	35 250	4 188	12%
	Shpenzimet korrente total	179 600	49 651	25%
4	Shpenzime kapitale	17 000		0
	TOTALI	196 600	49 651	25%

Grandi i financuar nga Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur

Nga grandi i financuar nga Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) për projektin "Mbështetja e drejtësisë tranzitore dhe trajtimi i të shkuarës në Shqipëri" për vitin 2026 është arkëtuar vlera 568,779 lekë.

Kjo vlerë do të mbulojë shpenzimet për pagesën e pagës dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të koordinatorit të projektit.

Për periudhën raportuese janë shpenzuar në total 568,779 lekë, në zërin shpenzime për paga në llogarinë 600 (të ardhura jashtë limitit). Ky projekt ka përfunduar.

IV. PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE NË NIVEL PRODUKTI

Në programin buxhetor 01110 "Planifikim, Menaxhim dhe Administrim", produkti 99501AA (Kërkesa të Trajtura) adresohen çështjet e barazisë gjinore që përbën një nga parimet themelore të të drejtave të njeriut dhe të funksionimit demokratik në Autoritet.

Trajtimi i barabartë ndërmjet grave dhe burrave është një detyrim ligjor dhe institucional, që synon të vlerësojë nivelin e zbatimit të parimeve të barazisë gjinore në AIDSSH.

Nëpërmjet monitorimit identifikohen arritjet, sfidat dhe nevojat për përmirësim në zbatimin efektiv të standardeve të barazisë gjinore.

Dokumenti gjithashtu synon të rritë transparencën, përgjegjshmërisë institucionale dhe forcimin e mekanizmave mbrojtës për garantimin e të drejtave të barabarta për të gjithë qytetarët, pa dallim gjinie.

- Numri i punonjësve gra në fund të 4-mujorit ndaj numrit të përgjithshëm të punonjësve gjithsej në institucion është 48 ose 68.5% ndaj totalit të numrit të përgjithshëm të punonjësve.
- Numri i punonjësve gra në poste drejtuese është 19 ndaj numrit total të drejtuesve që është 26. E shprehur në % është afërsisht 73% e totalit.
- Në total në Autoritet janë 5 punonjës me tituj shkencorë, 4 nga të cilat janë punonjëse gra.
- Për periudhën 4-mujore janë kryer 7 aktivitete ku përfshihen aktivitete për ndërgjegjësim qytetar, simpoziume, konferenca, përkujtime, klubi i librit të cilat janë organizuar nga drejtuese gra.

Puna, organizimi dhe pjesëmarrja në aktivitete të drejtuesve gra në Autoritet është bashkëpunuese dhe ndikon drejtpërdrejt në performancën e institucionit.

Gratë janë tregues kyç i rëndësishëm nëpërmjet të cilit hartohen politikat e institucionit, shprehet realizimi financiar dhe performanca e tij dhe rrjedhimisht edhe realizimi i produkteve/objektivave të cilit i jepet përparësi.

- Në kuadër të procesit raportues 4 muajor lidhur me kërkesat për periudhën kalendarike Janar-Prill 2026, për Drejtorinë e Marrëdhënieve Ndërinstitucionale në Procesin e Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur, nga familjarë dhe të afërm të personave të zhdukur janë 15 kërkesa të reja sipas Formularit Tip të miratuar nga Autoriteti. Në lidhje me aspektin gjinor, 2 prej kërkuesve/aplikuesve janë gra.
- Përsa i takon numrit të kërkesave që kanë të bëjnë me informimin, qasjen dhe vënien në dispozicion të materialeve arkivore të ish-sigurimit të shtetit, institucioneve, studiuesve dhe kërkuesve shkencorë, vendas dhe ndërkombëtarë, si dhe mediave shqiptare ose të huaja nga Drejtoria e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar, theksojmë se në periudhën Janar-Prill 2026 nga 65 kërkesa të reja studimore, 21 kërkuese janë gra.
- Nga Drejtoria e Informacionit e cila trajton: i) trajtimin e kërkesave të palëve të prekura, të treta, bashkëpunëtorëve dhe të favorizuarve; ii) trajtimin e kërkesave nga çdo person

dhe kujdesjen për shërbimet rehabilituese ndaj qytetarëve, nga 213 kërkesa të hyra gjatë 4-mujorit 2026, kanë hyrë 213 kërkesa nga të cilat 52 nga kërkueset gra dhe 14 kërkesa për gra .

- Për periudhën 4-mujore në Drejtorinë e Verifikimit të Figurave kanë hyrë 59 kërkesa institucionale ku nga 94 kandidatë për verifikim 19 janë gra.

Buxheti gjinor është një tregues i rëndësishëm i performancës me bazë gjinore që kontribuon në hartimin e politikave më gjithëpërfshirëse dhe në zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik të cilit i jepet përparësi edhe për të ardhmen.

V. PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVEL PROGRAMI

V.1 Performanca financiare e programit buxhetor

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit buxhetohet vetëm nëpërmjet 1 (një) programi buxhetor “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” me kod 01110 i cili ka në strukturë 1 (një) produkt buxhetor “Kërkesa të trajtuara” me kod 99501AA

Ecuria e shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik, paraqitet si më poshtë:

I. **Shpenzimet Korrente janë realizuar në masën 25% e planit të shpenzimeve korrente:**

- Shpenzime për paga artikulli 600 në masën 32%
- Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore artikulli 601 në masën 29%
- Shpenzimet operative, artikulli 602, në masën 12% .
transferrat nga buxheti, artikulli 606, në masën 29 %

II. **Shpenzimet kapitale në planin financiar nuk janë realizuar**

Realizimi i buxhetit për periudhën 4-mujore në mijë lek paraqitet në tabelën me poshte:

EMERTIMI	Viti 2025		Periudha raportuese 4/Mujori 2026								% e realizimit me planin
	Shpenzime faktike	Struktura në %	Plani Filleshtar Vjetor Viti 2026	Struktura e shpenzimeve në %	Plani i Risikuar Viti 2026	Struktura në %	Ndryshimi I planit 2026	Shpenzimet faktike 4/mujori 2026	Struktura në %	Ndryshimi (Plan - Fakt)	
	1	2	3	4	5	6	7(5-3)	8	9	10(5-8)	
Shpenzimet e Programit											
Planifikim-Menaxhim -Administrim	159,480	96%	196,450	100%	196,600	100%	150	49,651	100%	146,949	25%
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte Limitit	1,788	86%	569		569		0	569		0	
Totali i shpenzimeve	161,268	96%	197,019		197,169		150	50,220		146,949	
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik											
Paga	115,274	99%	122,050	62%	122,050	62%	0	39,050	79%	83,000	32%
Sigurime Shoqërore	18,809	98%	22,300	11%	22,300	11%	0	6,413	13%	15,887	29%
Mallra dhe Shërbime të Tjera	17,399	77%	35,100	18%	34,700	18%	-400	4,026	8%	30,674	12%
Trans per Buxh. Fam. & Individ	456	81%			550	0%	550	162	0%	388	29%
Totali Shpenzime Korrente	151,938	96%	179,450		179,600	91%	150	49,651	100%	129,949	25%
Totali Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	7,542	92%	17,000	9%	17,000	9%	0		0%	17,000	0%
Totali i shpenzimeve Buxhetore	159,480	96%	196,450	100%	196,600	100%	150	49,651	100%	146,949	25%
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit Korrente (Kap 06)	1,788	86%	569		569		0	569		0	
Totali (Korrente + Kapitale + Shpenz. nga te ardh. jashte limti	1,788	86%	569		569		0	569		0	
Numri i Punonjesve	70		73		73			69			

V.2 Performanca jo - financiare e programit buxhetor

Autoritet ka parashikuar në programin e tij buxhetor të vitit 2026 realizimin e treguesve të performancës në nivel qëllimi si dhe objektivat e politikës së programit.

Misioni, qëllimi dhe objektivat e Autoritetit identifikohen me një sërë treguesish, objektivash dhe produktesh të cilat paraqesin në shifra misionin dhe synimin e Autoritetit për të ardhmen. Më poshtë gjeni realizimin e treguesve të performancës, objektivat e politikës së programit dhe produkteve të programit.

Treguesi i performancës në nivel qëllimi për 4- mujorin paraqitet me

- Numrin e aktiviteteve dhe botimeve 11 ose 12% e planit
- Numrin e kërkesave 267 ose 28% e planit

Objektivat e politikës së programit për 4-mujorin shprehen nëpërmjet

- Numrit të faqeve të vëna në dispozicion 25039 ose 28% e planit
- Numri i ankesave është zero ose 100%
- Përqindjen e grave në poste drejtuese të institucionit ndaj totalit të posteve drejtuese 73% ose 108% e planit
- Numri i rasteve të diskriminimit me bazë gjinore të trajtuara është zero ose 100% e planit

Produkti “ Kërkesa të trajtuara “ me kod 99501AA ka të bëjë me trajtimin e të gjitha kërkesave të paraqitura në Autoritet si dhe aktiviteteve të ndryshme të realizuara në kuadër të ndërgjegjësimit të individit dhe institucioneve për të drejtën e tyre/aksesin në informacionin/dokumentacionin arkivor të Autoritetit. Ky produkt është realizuar në masën 28 % .

Produktit “Kërkesa të trajtuara” për 12-mujorin është 512. Këtu përfshihen:

- Numri i kërkesave sipas objektit të tyre
 1. Kërkesa Individuale 388
 2. Kërkesa Studimore 65
 3. Kërkesa Institucionale 59
- Aktivitetet në kuadër të ndërgjegjësimit të individit (simpoziume, konferenca, përkujtimore), leksione të hapura, klube libri në total është 11.
- Numri i faqeve të vëna në dispozicion është 25.039 .
- Është bërë përpunimi i 50.692 faqeve/fletëve të trajtuara, të digjitalizuara të cilat 5.068 faqe janë të anonimizuara
- Numri i dosjeve: 615, 50 692 faqeve/fletëve të trajtuara, të digjitalizuara, vënë në dispozicion);
- 28 studiues kanë frekuentuar 112 herë sallën e bibliotekës për studimet e tyre.
- 1691 faqe të blera nga 8 studiues të pavarur, ndërkohë 6 studiues kanë tërhequr për 13 kërkesa të ndryshme 8 295 faqe falas në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet partnere ISKK si dhe Instituti “Ali Hadri” dhe Instituti Albanologjik në Prishtinë
- 24 kërkesa studimore nga institucione partnere, studentë për punime diplome
- 3 kërkesa mediatike me qëllim realizim reportazhi, artikulli, shkrim memuaristik

V.3 Veprimet vijuese në nivelin e programit buxhetor

Në nivelin e **programit buxhetor**, për të mundur realizimin me sukses të objektivave puna do të përqëndrohet kryesisht në veprimet/aktivitetet e organizuara sipas qëllimeve dhe objektivave të programit ku përfshihen kryesisht:

- Përcaktimi i objektivave dhe rezultateve të pritshme
- Hartimi i aktiviteteve dhe parashikimi i kostove që do të realizohen
- Parashikimi i kostove dhe burimeve financiare dhe shpërndarja sipas zërave ekonomikë

- Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe materiale.

Veprimet vijuese në nivelin e programit buxhetor do të lidhen me ndjekjen e realizimit të shpenzimeve dhe krahasimin e rezultateve me objektivat e Autoritetit me qëllim përmirësimin e zbatimit, përdorimit të fondeve dhe arritjes së objektivave.

Referuar realizimit të shpenzimeve për periudhën Janar-Prill 2026, për të mundësuar realizimin me sukses të objektivave deri në fund të vitit 2026 puna do të përqëndrohet kryesisht në:

- a. Obligimin e burimeve njerëzore veçanërisht në ato procese që deri tani nuk paraqiten të realizuara
- b. Rishikimin e planit të prokurimeve;
- c. Marrjen e masave/veprimeve parandaluese si përmirësimin e procedurave të zbatimit, monitorimit të shpeshtë të shpenzimeve dhe përshtatjen e objektivave sipas nevojave reale.

Vëmendje do t'i kushtohet rritjes së cilësisë së dokumentave/procese të punës që është thelbësore për përmirësimin e rezultateve dhe realizimin e planit që lidhet me prokurimin e fondeve buxhetore, për të reduktuar në maksimum riskun e mosrealizimit të procedurave. Gjithashtu vëmendje do ti kushtohet përmirësimit të efikasitetit për kryerjen sa më mirë të punës, sa më shpejt dhe me sa më pak shpenzime lidhur me aktivitetet e përcaktuara në kuadër të realizimit të objektivave.

VI. PROJEKTET KAPITALE

Nuk kemi projekte të mëdha kapitale në implementim.

VII. NRYSHIMET NË BUXHET

Buxheti i planifikuar në fillim të vitit në total ishte **196,450,000 lekë**. Gjatë vitit kemi ndryshime në buxhet dhe rialokim fondi si më poshtë:

- Alokim fondi i veçantë me shkresën nr.1868/1, datë 16.02.2026 të Ministrisë së Financave, “Mbi miratimin e detajimit të planit për fondin e veçantë për vitin 2026” në vlerën 150.000 lekë në llogarinë 606 (transfera tek individët).
- Rialokim fondi me shkresën nr.1868/1, datë 17.02.2026 të Ministrisë së Financave, “Mbi miratimin e rialokimit të buxhetit për vitin 2026” në vlerën 400.000 lekë në llogarinë 606 (transfera tek individët) duke pakësuar llogarinë 602(mallra dhe shërbime).

Buxheti me ndryshime në total për vitin 2025 është **196,600,000 lekë**.

Aktualisht fondet janë të alokuar tek një program buxhetor dhe nuk kemi kalime ndërmjet programesh por kemi ndryshim ndërmjet produkteve, zërave dhe artikujve artikujve.

VIII. PËRFUNDIME

Në mbështetje të Ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH” i ndryshuar, qëllimi përcaktues dhe detyra prioritare e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë është marrja në shqyrtim e kërkesave të paraqitura nga individët si dhe aktivitetet ndërgjegjëse.

Për realizimin e Buxhetit të 4-mujorit të vitit 2026 është punuar dhe janë angazhuar të gjitha strukturat e Autoritetit me qëllim përdorimin me efikasitet dhe efektivitet të fondeve të planifikuara.

Realizimi i buxhetit për këtë periudhë është monitoruar me përgjegjësi nga Grupi i Menaxhimit Strategjik.

Produktet e realizuar për vitin 2026 janë :

- Kërkesa individuale
- Kërkesa institucionale
- Kërkesa studimore
- Klubi i librit
- Aktivitete ndërgjegjëse (simpoziume, konferenca, përkujtime)

Performanca financiare e Programit Buxhetor paraqet nivelin e realizimit të objektivave financiare dhe përdorimit efikas të fondeve publike, përmirëson realizimin e objektivave të programit, rrit përgjegjshmërinë dhe transparencën institucionale dhe siguron përdorim më racional të fondeve publike .

Monitorimi i vazhdueshëm i buxhetit mundëson identifikimin e problemeve dhe devijimeve gjatë zbatimit të tij. Përmes veprimeve vijuese, si masat korrigjuese, rishikimi i planeve financiare dhe përmirësimi i kontrollit të brendshëm rritet eficientia në menaxhimin e fondeve publike.

Në përfundim, një menaxhim i mirë i performancës financiare:

- përmirëson realizimin e objektivave programore;
- rrit përgjegjshmërinë dhe transparencën institucionale;
- siguron përdorim më racional të burimeve publike;
- ndikon pozitivisht në cilësinë e shërbimeve publike dhe zhvillimin ekonomik.

Në ushtrim të detyrës është punuar me prioritet në kuadër të procesit të mbrojtjes të të dhënave gjatë përpunimit dhe dhënies së informacionit, në mënyrë të veçantë e atyre të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar si dhe zbatimi i përpiktë i Ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar), si dhe Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejta për Informim”.

Krahas garantimit të integritetit të procesit në përgjithësi në dhënien e informacionit, duke e bërë këtë të fundit, lehtësisht të aksesueshëm, të saktë dhe të plotë, për aq sa e lejon ligji, në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale, interesit publik dhe sigurisë kombëtare.

ANEKSI nr.1 Raporti Përmbledhës i Shpenzimeve të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit

në/lehtë

Emri i Grup Autoritetit për të Drejtën e Informimit									
Kodi i grupit 95									
Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit									
Viti pararendës 2025		Periodua raportuese		Periodua raportuese		Periodua raportuese		Periodua raportuese	
Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Plani i Rialtkuar Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi i planit	Shpenzime Faktike të Periudhës/Prognostik	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi 4-mujor (Plan - Fakt)
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	7 (5-3)	(8)	(9)	10 (5-8)
Shpenzimet sipas programeve buxhetore									
Emërtimi									
01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		159,480,173.00	100	196,450,000.00	100	0.00	49,650,827.00	100	146,799,173.00
Totali i Shpenzimeve buxhetore të Ministrisë (Kap 01,02,03,04,05,08,22)		159,480,173.00	100	196,450,000.00	100	0.00	49,650,827.00	100	146,799,173.00
Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë Ilimitit (Kap 06)		1,798,000.00		568,779.00			568,779.00		0.00
Totali Shpenzimeve të Ministrisë		161,268,173.00					50,219,606.00		146,799,173.00
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik									
Emërtimi									
600 Paga		115,274,367.00	72	122,050,000.00	62		39,049,761.00	79	83,000,239.00
601 Sigurime Shpëtojore		18,808,948.00	12	22,300,000.00	11	0.00	6,413,212.00	13	15,886,788.00
602 Mollë dhe Shërbime të Tjera		17,398,669.00	11	35,100,000.00	18	-400,000.00	4,026,009.00	8	30,673,991.00
603 Subvencione		0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00
604 Transferata Korante të Brendshme		0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00
605 Transferata Korante të Huaja		0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00
606 Tërës për Buxh, Fam. & Individ		455,961.00	0	0.00	0	550,000.00	161,845.00	0	388,155.00
Non-Totali Shpenzime Korrente		161,537,985.00	95	179,450,000.00	91	179,600,000.00	49,650,827.00	100	129,949,173.00
230 Kapitale të Palupëzuara		0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00
231 Kapitale të Tropicuara		7,542,188.00	5	17,000,000.00	9	0.00	0.00	0	17,000,000.00
Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm		7,542,188.00	5	17,000,000.00	9	0.00	0.00	0	17,000,000.00
230 Kapitale të Palupëzuara		0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00
231 Kapitale të Tropicuara		7,542,188.00	5	17,000,000.00	9	0.00	0.00	0	17,000,000.00
Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim të huaj		0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00
Totali Shpenzime Kapitale		7,542,188.00	5	17,000,000.00	9	0.00	0.00	0	17,000,000.00
Totali i Shpenz. Buxhetore të Ministrisë/Institucionit Buxhetor		159,480,173.00	100	196,450,000.00	100	0.00	49,650,827.00	100	146,799,173.00
Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë Ilimitit (Kap 06)		1,798,000.00		568,779.00			568,779.00		
Totali (Korrente + Kapitale + Shpenz.nga të ardh. jashtë ilimit)		161,268,173.00		197,018,779.00		150,000.00	50,219,606.00		
Numri i punonjësve		70		73		73		69	

Sekretari i Përgjithshëm

Emri	Sot/ Mbi
Firma	
Data	25.05.2026



ANEKSI 1.1 Raporti i Shpenzimeve të Institucionit sipas kapitujve

Periodha e Raportimit 04-2026

Kodi i AIDSSH	Kodi i Kapitullit	Emërtimi i Kapitullit	Periudha raportuese	Buxheti	Artikujt buxhetore					
					231	600	601	602	606	Total
			Periodike /Vjetore	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara	Pagat	Kontrib. e Sigurimeve Shpërndara	Mallia dhe Shërbime	Transferita për Buxhetet Familjare dhe Individët	Total	
95	01	Nga Buxheti	2026	Plani fillestar	17,000,000	122,050,000	22,300,000	35,100,000	0	196,450,000
95	01	Nga Buxheti	2026	Plani i rishikuar	17,000,000	122,050,000	22,300,000	34,700,000	550,000	196,600,000
95	01	Nga Buxheti	2026	Fakti	0	39,049,761	6,413,212	4,026,009	161,845	49,650,827
95	01	Nga Buxheti	2026	Angazhime	0	0	0	0	0	0
95		Total	2026	Plani fillestar	17,000,000	122,050,000	22,300,000	35,100,000	0	196,450,000
95		Total	2026	Plani i rishikuar	17,000,000	122,050,000	22,300,000	34,700,000	550,000	196,600,000
95		Total	2026	Fakti	0	39,049,761	6,413,212	4,026,009	161,845	49,650,827
95		Total	2026	Angazhime	0	0	0	-400,000	550,000	150,000
95		Ndryshimi ne vlerë absolute	2026		0	0	0			
95		Realizimi ne %	2026		0	32	29	12	29	25
95	06	Nga të ardhurat jashtë limitit	2026	Fakti	0	568,779	0	0	0	568,779
95	06	Nga të ardhurat jashtë limitit	2026	Angazhime	0	0	0	0	0	0

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Antion Dukagjini	Sekretari i Përgjithshëm	Emri	Sofi Noçi
	Firma			Firma	
	Data	25.05.2026		Data	25.05.2026



Aneksi 1.2 "Shpenzimet Buxhetore në Total Programi dhe Total Institucionit"

Kodi i Ministrisë	Kodi i Programit	Emërtimi i Programit	Viti	Tipi i Buxhetit	Art. 231	Art. 600	Art. 601	Art. 602	Art. 606	Total
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2026	Plani fillestar	17,000,000	122,050,000	22,300,000	35,100,000	0	196,450,000
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2026	Plani i rishikuar	17,000,000	122,050,000	22,300,000	34,700,000	550,000	196,600,000
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2026	Shpenzime faktike	0	39,049,761	6,413,212	4,026,009	161,845	49,650,827
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2026	Angazhime	0	0	0	4,369,947	0	4,369,947
95		Ndryshimi në vlerë absolute	2026		0	0	0	-400,000	550,000	150,000
95		Realizimi në %	2026		0	32	29	12	29	25
95		Te ardhura jashtë limiti	2026	Shpenzime faktike	0	568,779	0	0	0	568,779
95		Total i Ministrisë/institucionit	2026	Plani fillestar	17,000,000	122,050,000	22,300,000	35,100,000	0	196,450,000
95		Total i Ministrisë/institucionit	2026	Plani i rishikuar	17,000,000	122,050,000	22,300,000	34,700,000	550,000	196,600,000
95		Total i Ministrisë/institucionit	2026	Shpenzime faktike	0	39,049,761	6,413,212	4,026,009	161,845	49,650,827
95		Total i Ministrisë/institucionit	2026	Angazhime	0	0	0	4,369,947	0	4,369,947
95		Numri i punonjësve në Total	2026	Plani fillestar		73	73			0
95		Numri i punonjësve në Total	2026	Plani i rishikuar		73	73			0
95		Numri i punonjësve në Total	2026	Numri faktik		69	69			0

Drejtoesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Anoq Dukagjini	Sekretari i Përgjithshëm	Emri	Soft Ndi
	Firma			Firma	
	Data	25.05.2026		Data	25.05.2026




ANEXSI nr. 2 Raporti mbi Ekzekutimin e Buxheut në nivelin e Programit të Buxheut

nëlekë

Emri i Grupit		Autoriteti për të Drejtën e Informimit		Kodi i grupit		95					
Emri i		Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		Kodi i programit		Shpenzimet e Programit		01110			
EMËRTIME		Viti paraardhës 2025		Përfundia raportuese		Përfundia raportuese		Ndryshimi (Plan - Fakt)		% e realizimit	
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Fikstër Vjetor Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Plani i Ristrukturuar Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi i planit	Shpenzime Faktike të shpenzimeve të shpenz		

	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	7,542,188.00	5	17,000,000	9	17,000,000	9	0	0.00	0	17,000,000	0
Kodi i produktit	Emeritimi											
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0
	Total Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit (Kap 06)	1,798,000.00		568,779		568,779		0	568,779.00		0	0
	Shpenzime korrente nga të ardhurat jashtë limitit (Kap 06)	1,798,000.00		568,779		568,779		0	568,779.00		0	0
Kodi i produktit	Emeritimi											
99501AA	Kërkesa të veçluara	1,798,000.00		568,779		568,779			568,779.00			0
Kodi i produktit	Emeritimi											
	Total i Shpenzimeve të Programit	161,268,173.00		197,018,779		197,168,779		150,000	50,219,605.00		146,948,173	25

Emri	Anton Dukagjini	Sekretari i Përgjithshëm		Emri	Sofi Noy
Firma		Firma		Firma	
Data	25.05.2026	Data		Data	25.05.2026




RAPORTI 2/1 Shpenzimet e programit sipas kapitujve

Periudha e Raportimit 04-2026

Kodi i AIDSSH	Kodi i Programit	Emërtimi i Programit	Kodi i Kapitullit	Mërtimi i Kapitullit	Periodike /Vjetore	Buxheti	Artikujt buxhetore						Total
							230	231	600	601	602	606	
						Shpenzime kapitule të përluajtura	Shpenzime kapitule të trupëzuara	Pagat	Kontributet e sigurimeve shoqërore	Mallë dhe shërbime	Transferatat për buxhetet familjare dhe individët	Total	
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	01	Nga Buxheti	2026	Plani fillestar	0	17,000,000	122,050,000	22,300,000	35,100,000	0	196,450,000
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	01	Nga Buxheti	2026	Plani i rishikuar	0	17,000,000	122,050,000	22,300,000	34,700,000	550,000	196,600,000
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	01	Nga Buxheti	2026	Fakti	0	39,049,761	6,413,212	4,026,009	161,845	49,650,827	
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	01	Nga Buxheti	2026	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		Total	2026	Plani fillestar	0	17,000,000	122,050,000	22,300,000	35,100,000	0	196,450,000
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		Total	2026	Plani i rishikuar	0	17,000,000	122,050,000	22,300,000	34,700,000	550,000	196,600,000
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		Total	2026	Fakti	0	39,049,761	6,413,212	4,026,009	161,845	49,650,827	
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		Total	2026	Angazhime	0	0	0	0	4,369,965	0	4,369,965
95	01110	Ndryshimi në vlerë absolute			2026		0	0	0	-400,000	550,000	150,000	
95	01110	Realizimi në %			2026		0	0	32	29	12	25	
95	01110	Te ardhura jashtë limiti	06		2026	Fakti	0	0	568,779	0	0	568,779	

